

**HYSEN KORDHA**

**NJËÇERЕК SHEKULLI KRYEGJYSHI BOTËROR  
I BEKTASHINJVE: SALI NJAZI DEDEJ<sup>1</sup>**

Ndihem i lumtur dhe i nderuar që Kryegjyshi Botëror bektashian, Shënjtëria e tij Dede Reshat Bardhi dhe departamenti i kulturës i Kryegjyshit Botëror Bektashian organizator të kësaj veprimtarie përkujtimore shkencore më besuan të trajtoj veprimtarinë e Sali Njazi Dedejt si kryegjysh botëror i bektashizmit. Ndaj i falënderoj nga zemra.

Tashmë dihet që historiografia shqiptare ka vlerësuar dhe ka vënë në dukje kontributet e bektashinjve shqiptarë dhe të institucioneve të tyre në çdo periudhë të historisë së kombit tonë. Në këtë proces shquhet edhe kontributi i Sali Njazi Dedejt. Por, kur gjykojmë e vlerësojmë kontributet e Sali Njazi Dedejt, duhet të kemi parasysh veçoritë e veprimtarisë së tij. Si kryegjysh Botëror i bektashinjve ai udhëhoqi gjithë bektashinjtë e botës nga 1916 deri më 1941, periudhë gjatë së cilës i shërbeu me devocion bektashizmit botëror, dhe kontribuoi në përparimin e tij. Pas vitit 1929 për shkak të rrethanave historike, të cilat do të analizoj më poshtë, Sali Njazi Dedejt u vu edhe në krye të bektashinjve shqiptar dhe dha kontribute të ndjeshme edhe në interes të zhvillimit e të përparimit të tyre, dhe të gjithë kombit Shqiptar. Pra, ai hyri dhe mbeti në historinë e bektashizmit botëror në përgjithësi, në historinë e bektashinjve shqiptarë dhe në historinë e kombit shqiptar.

Për një çerekshkulli nga viti 1916 deri në vitin 1941 kur e vranë Ai ishte Kryegjysh Botëror i bektashinjve. Gjatë kësaj periudhe Sali Njazi Dedejt luajti roli vendimtar për fatet e bektashizmit, sidomos për ruajtjen e vazhdimësisë së veprimtarisë të bektashinjve gjatë viteve 20-të të shek XX dhe për sjelljen e Kryegjyshit Botëror Bektashian nga Turqia në Shqipëri. Pas Kongresit bektashian të Korçës që u mbledh në vjeshtë të vitit 1929 me pëlqimin e gjithë Baballarëve Bektashinj të Shqipërisë iu besua edhe detyra e lartë dhe e Shënjtë,

---

<sup>1</sup> Kumtesë e mbajtur në Sesionin Shkencor kushtuar 65-vjetorit të rënies së Njazi Dedejt, organizuar nga Kryesia Botërore Bektashiane, më 27.11.2006.

Kryegjysh i bektashinjve Shqiptarë duke mbajtur njëherazi edhe titullin Kryegjysh i përbotshëm<sup>2</sup>. Ai njihet si themeluesi i Kryegjyshit<sup>3</sup> në vendin tonë, fakte që i bënin dhe i bëjnë nder kombit shqiptar. Kjo shpjegon edhe arsyen e atij entuziazmi dhe gëzimi të madh me të cilin u prit ardhja e tij në Shqipëri në vitin 1930<sup>4</sup>.

Ai ka merita të veçanta historike sepse iu përgjigj me përgjegjësi dhe vetëdije të lartë fetare dhe me atdhetarizëm detyrave që i diktuan rrethanat historiko-politike gjatë periudhës çerekshekullore që drejtoi e udhëhoqi me kompetencë, përkushtim, mençuri dhe konsekuencë, qendrën botërore të bektashizmit. Dokumentacioni provon se Sali Njazi Dedej ishte një figurë madhore e patriotizmit shqiptar. Mesazhet e veprës dhe të filozofisë së veprimit të tij janë gjithnjë aktuale dhe me vlera të gjithanëshme jo vetëm fetare por edhe atdhetare. Ato rrezatonin devotshmëri ndaj dogmës fetare, mirëkuptim, bashkekzistencë, tolerancë, harmoni në marrëdhëniet ndërfitare, përkushtim ndaj ndjenjës dhe idesë atdhetare. Sali Njazi Dede ishte nga ata klerikë të lartë bektashianë, ndërgjegjia fetare e të cilit "nuk e errësoi dhe nuk e mbuloi asnjëherë vetëdijen e kombësisë"<sup>5</sup> shqiptare. Me veprimtarinë e tij vërtetoi dhe dëshmoi thënien lapidare të Sami Frashërit se "Shqiptari është shqiptar para se të jetë mysliman a i krishterë"<sup>6</sup> dhe se motua themelore e veprimtarisë së tij ishte "Pa atdhe nuk ka fe"

### **Kush ishte Sali Njazi Dedej**

Ai lindi në 5 mars 1876 në fshatin Starje të Kolonjës, në një familje atdhetare me besim bektashian. Qysh në moshë të re me familjen e tij emigroi në Anadoll të Turqisë<sup>7</sup>. Në përmbledhjen e biografisë hartuar më 28 mars 1941 dhe nënshkruar prej tij, Sali Njazi Dedej pohon se pasi kreu gjimnazin turqisht<sup>8</sup>, në vitin 1896 filloi të frekuentonte mësimet fetare në

<sup>2</sup> Arkivi i Kryegjyshit të Botërore Bektashiane (më tutje: AKBB): Përmlledhja e biografisë së Kryegjyshit të Bektashinjvet, dokument i daktilografuar, datë 28 mars 1941-XIX.

<sup>3</sup> Po aty.

<sup>4</sup> Zija Basha, *Kryegjyshi që u vra nga fashistët*, gazeta "Dita Jug", 04.02.2001.

<sup>5</sup> Kristaq Prifti, *Diversiteti fetar dhe uniteti kombëtar te shqiptarët*, në: "Studime historike", 1-2/2001, f. 26.

<sup>6</sup> Po aty.

<sup>7</sup> Baba Rexhepi, *Sali Njazi Dedej*, revista "Urtësia", Nr.8, nëntor 1996, f. 20.

<sup>8</sup> AKBB, dok. i cit.

Teqen e Haxhi Bektash Veliut, ku u njoh me “mësimet bazë të parimeve teologjike kuranore dhe në veçanti me doktrinën bektashiane të frymëzuar dhe të mbështetur në filozofinë e Haxhi Bektash Veliut”<sup>9</sup>. Nga momenti që nisi mësimet fetare ai iu përkushtua dogmës fetare dhe rrugës së mësimëve të themeluesit të bektashizmit, Haxhi Bektash Veliut, të cilit i qëndroi konseguent deri në fund të jetës. Dokumentacioni arkivor dëshmon qartë procesin e përgatitjes teologjike të tij dhe rrugën e ngjitjes në hierarkinë klerikale bektashiane. Më 1897 u bë myhib i Fejzi Dedejt<sup>10</sup>, - thekson Baba Rexhepi dhe Dervish, - e pas dy vjetësh, më 1899 u bë Myxheret. Më 1901 u gradua baba. Në vitin 1906, kryegjyshi botëror i bektashinjve Fejzi Dedej duke njohur e vlerësuar përgatitjen e Sali Njazi Dedej, dhe duke pasur besim të plotë në aftësitë e tij, e ngarkoi me një mision të rëndësishëm, të cilin Sali Njazi Dede e përmbushi me sukses<sup>11</sup>. Pas kthimit nga misioni u bë anëtar i këshillit të lartë të klerit bektashian. Më 1913 u gradua Gjysh dhe më 1914 arriti gradën më të lartë që ka bektashizmi, Kryegjysh (Dede) babai i gjithë Baballarëve<sup>12</sup>. Që asokohe figura e tij ngërthente në vetvete klerikun me kulturë të gjerë, me përgatitje të gjithanëshme e të thellë teologjike, me identitet fetar të spikatur, me aftësi organizative dhe drejtuese të shquara<sup>13</sup>. Prandaj menjëherë pas vdekjes së Kryegjyshit Botëror Fejzi Dedej, Këshilli Gjyshnor i Kryegjyshit Botëror Bektashiane, më 1916 e zgjodhi dhe e emëroi Sali Njazi Dedejn, Kryegjysh Botëror<sup>14</sup>. Që nga ai moment e deri sa qe gjallë (plot një çerekshekulli) Sali Njazi Dedej ishte në postin më të lartë të hierarkisë klerikale bektashiane. Si drejtuesi më i lartë i klerit bektashian dhe në saj të punës plot devocion e përkushtim në shërbim të bektashizmit e të dogmës fetare bektashiane “shpejt u bë i njohur në rrethet klerikale bektashiane të Turqisë, Egjiptit, Sirisë, Iranit, Greqisë, Bullgarisë, Rumanisë, Austrisë, Gjermanisë etj.”<sup>15</sup>. Duke shprehur në mënyrë sintetike vlerat fetare, njerëzore e morale të figurës së atij kleriku

<sup>9</sup> Kujtim Ahmataj, *Sali Njazi Dedej*. Zë i përgatitur për Fjalorin Enciklopedik Shqiptar, dorëzuar në Qendrën e Enciklopedisë Shqiptare, pranë Akademisë së Shkencave të R.Sh.

<sup>10</sup> Baba Rexhepi, *art. i për.*

<sup>11</sup> *Po aty*.

<sup>12</sup> *AKBB, dok. i cit.*

<sup>12</sup> Kujtim Ahmataj, *pun. i për.*

<sup>14</sup> Zija Basha, *art. i për.*

<sup>15</sup> Kujtim Ahmataj, *pun. i për.*

të lartë bektashian në një dokument theksohet se kushdo që pati rastin ta njihnte nuk mund të mos “e adhuronte fetarin e kënduar, shqiptarin e punës, predikatorin e së mirës”<sup>16</sup>. Ndërsa një avokat që pati rast ta takonte pohonte se në “personin e Sali Njazi Dedejt kishte gjetur një fytyrë të ndritur e një mëndje e hov përparimdashës”<sup>17</sup>.

Sikurse dihet në vitin 1925 me vendim të qeverisë turke u mbyllën teqetë bektashiane dhe u ndalua veprimtaria e tyre. Në këtë kuadër u mbyll edhe Teqeja në Haxhi Bektash, ndaj Sali Njazi Dedejt u detyrua të ikte nga Anadulli dhe të vendosej në Ankara<sup>18</sup>. Për bektashizmin dhe bektashinjtë u krijuan situata dhe rrethana të vështira. Pikërisht në ato momente të rënda shkëlqeu edhe njëherë zotësia, mençuria, shpirti dhe ndërgjegjja e thellë fetare dhe shqiptarizmi i Sali Njazi Dedejt. Siç ka pohuar me të drejtë Baba Edmond Brahimaj (dhe unë pajtohem plotësisht me pikëpamjen e tij) se edhe pse “nga shtete të tjera të udhës bektashiane pati propozime që kryeqendra bektashiane së bashku me Kryegjyshin Sali Njazi Dedej të vendosej në vendet e tyre, por respekti, dashuria, përkushtimi e mbi të gjitha zëri i atdheut bëri që Sali Njazi Dedej këtë respekt e nderi’ia bënte vendit të tij të dashur, duke ardhur në Shqipëri e duke mbetur kështu Kryegjysh botëror i Bektashinjve dhe kryetar i Komunitetit bektashian shqiptar”<sup>19</sup>.

Do të ndalem pak në analizën e faktit të transferimit të Selisë së Kryegjyshatës botërore nga Anadulli në Tiranë. Ajo përbën një meritë të madhe historike të atij personaliteti. Momenti ishte historik, madje mund të thuhet kthesë historike sepse ndryshonte vendndodhja e Qendrës Botërore të bektashinjve. Dilemën që u krijua mbas vendimeve të Qeverisë Turke për ndalimin e veprimtarisë së Kryegjyshatës në territorin e shtetit turk, Sali Njazi Dedej e zgjidhi në favor të kombit dhe të shtetit shqiptar. Sali Njazi Dedej duke sjellë në Shqipëri Institucionin më të lartë botëror bektashian ishte i bindur dhe kishte besim të patundur tek bektashinjtë shqiptarë, tek i gjithë populli dhe tek qeveria shqiptare se ata do ta mirëprisnin. Pra vështuar nga ky aspekt, Sali Njazi Dedej del si një atdhetar vizionar i madh, sepse që nga ai moment Shqipëria u shndërrua në vendin ku ndodhej dhe vepronte Institucioni më i lartë bektashian

<sup>16</sup> Gazeta “Tomorri”, Tiranë, 3 dhjetor 1941.

<sup>17</sup> Po aty.

<sup>18</sup> Baba Rexhepi, *art. i për.*

<sup>19</sup> Baba Edmond Brahimaj, *Bektashizmi dhe Alevizmi*, në revistën “Urtësia”, Nr.48, tetor 2005, f.21.

botëror. Në këtë veprim të tij shihet qartë largpamësia, patriotizmi dhe shqiptarizmi i kulluar i Sali Njazi Dedejt. Dhe këtë ai e bëri me ndërgjegje për popullin dhe kombin e tij, si një shqiptar që nuk e harroi asnjëherë kombin e vet. Ai ishte i vetëdijshëm se me këtë veper i shërbente drejtpërdrejtë Shqipërisë dhe shqiptarëve, sepse ajo ia ngrinte më lartë vlerat Shqipërisë dhe bashkëkombasve të vet. Duke analizuar dhe shpjeguar shkaqet e rrënjët e këtij veprimi atdhetar të tij, një dokument thekson se Sali Njazi Dedej “duke ndjerë mallin e vendit të tij të dashur u kthye në Tiranë dhe e bëri këtë Qendër të bektashizmit<sup>20</sup>”.

Kongresi i III Bektashian Shqiptar që i zhvilloi punimet në Teqenë e Turanit në shtator të vitit 1929 vendosi që “Selia e shënjtë e Kryegjyshit Botërore Bektashiane të jetë në Shqipëri dhe në postin e Kryegjyshit botëror të ishte Sali Njazi Dedej<sup>21</sup>”, të cilit iu ngarkua edhe funksioni i Kryegjyshit të bektashinjve Shqiptar. Ky moment shënon një kthesë në historinë e bektashinjve shqiptarë sepse me reformat që nisi dhe me masat e gjithanëshme që mori Sali Njazi Dedej i dha shtysë të re funksionimit të institucioneve dhe veprimtarive fetare bektashiane në Shqipëri. Ai e ngriti shumë bektashizmin shqiptar, veshi dervishë e baballarë, organizoi botimin e literaturës për arsimimin<sup>22</sup> e kuadrove etj. Si Kryegjysh i bektashinjve shqiptarë ai qysh në fillim u drejtoi një qarkore gjithë qendrave gjyshore dhe prindërive bektashiane të Shqipërisë. Nëpërmjet Qarkores u komunikonte vendimet e Mbledhjes së parë të Këshillit të Shenjtë Gjyshnor për të vënë në baza më të shëndosha organizative gjithë veprimtarinë fetare. Midis të tjerash në Qarkore me tone kategorike urdhërohej “i tërë kleri bektashi të zbatonte me rreptësi disiplinën shembullore të Haxhi Bektashit duke kryer detyrat fetare me një pastërti morale pa u përzier në punë politike as një grimë e në asnjë mënyrë<sup>23</sup>”. Ndërsa në deklaratën e mbledhjes shpallej se i tërë kleri bektashian i Shqipërisë do të vepronte me disiplinë shembullore “në bazë të rregullave kanunore të besimit bektashian dhe të ligjeve<sup>24</sup> të shtetit shqiptar. Këshilli Gjyshnor Shqiptar nën kryesinë e Kryegjyshit Sali Njazi Dedej shpallte botërisht se qëllimi i “programit të punës së tij ishte përparimi i bektashizmit, vëllazërimi i gjithë popullit shqiptar, shërbimi moral për shtimin e lavdisë së kombit dhe të mbretërisë shqiptare<sup>25</sup>”. Mbështetur në rolin dhe vlerat e

<sup>20</sup> Gazeta “Tomorri”, Tiranë, 30 nëntor 1941.

<sup>21</sup> Revista “Urtësia”, Nr. 42, dhjetor 2004, f. 9.

<sup>22</sup> Zija Basha, *art. i për.*

<sup>23</sup> “Gazeta e Korçës”, Korçë, 03.05.1930.

<sup>24</sup> Po aty.

<sup>25</sup> Po aty.

këtyre masave dhe mjaft të tjera si këto, në dokumente të kohës vihej në dukje se “sot e mbas këndeje, besimi bektashian... duket ... që po merr një vrull të ri përparimtar në udhën e tij të drejtë e të papërlyeme”<sup>26</sup>, besim që predikon drejtësi, dashuri, urtësi, liri, disiplinë, vëllazëri, paqe, mirësi etj.

Ndonëse në Shqipëri u vendos dhe nisi të vepronte qendra botërore e bektashizmit, gjithsesi, sikurse thekson Baba Rexhepi “Kryegjyshitës i mungonte një teqe presigjoze”<sup>27</sup>. Këtë fakt e ndjente dhe kuptonte Sali Njazi Dedej, i cili e vlerësonte si një nevojë dhe detyrë që domosdoshmërisht duhej plotësuar. Ndaj në saj të përpjekjeve këmbëngulëse të Sali Njazi Dedejt, në mirëkuptim të plotë me qeverinë e kohës, e cila kontribuoi edhe në një pjesë të nevojave financiare në fund të viteve '30, të shek. XX filloi ndërtimi i godinës së re e të bukur të Kryegjyshitës në Tiranës, e cila përfundoi në vitin 1941<sup>28</sup> dhe që vazhdon të jetë edhe sot Selia e Kryegjyshitës Botërore bektashiane. Ai kishte kuptim e koncepte të drejta për rolin dhe vlerat e këtij institucioni me përmasa botërore<sup>29</sup>, prandaj u kujdes personalisht për ndërtimin e funksionimin e saj.

Sali Njazi Dedej bashkëpunoi ngushtësisht me qeverinë e asaj kohe për hartimin e legjislacionit mbi fenë dhe për përcaktimin e raporteve të shtetit me institucionet fetare<sup>30</sup>. Si personalitet me kulturë dhe interesa të gjera Sali Njazi Dedej u shfaq edhe me krijimtari letrare si shkrimtar. Ai e priti më shqetësim pushtimin e Shqipërisë nga fashistët italianë dhe nuk zhvilloi një propagandë aktive në favor të fashizmit italian<sup>31</sup>. Më 27 nëntor 1941, plot 65 vjet më parë, fashistët organizuan vrasjen e tij. Ai vdiq i nderuar dhe u varros me nderimet e respektin e gjithë kombit shqiptar dhe të besimtarëve të të gjitha komuniteteve fetare, duke lënë pas një trashëgimi të vyer dhe jehonën e mesazhet e veprës së tij të pavdekshme.

Dhe në këto momente të përkujtimit të jetës dhe veprës së këtij apostulli të bektashizmit, na buron nga shpirti lutja që shembulli dhe mesazhet e veprës së tij të jenë nëpër rrjedhë të shekujve, rreze e pashuar drite në rrugën që do të vazhdojnë njeri pas tjetrit brezat që do të vijnë<sup>32</sup>.

<sup>26</sup> Po aty.

<sup>27</sup> Po aty.

<sup>28</sup> Po aty.

<sup>29</sup> Baba Edmond Brahimaj, *art. i për.*

<sup>30</sup> Kujtim Ahmataj, *pun. i për.*

<sup>31</sup> Xhelal Gjeçovi, *Kleri mysliman dhe çështja kombëtare në vitet e Luftës së Dytë Botërore*, revista “Perla”, nr.3, 2006, f.122.

<sup>32</sup> *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë*, Fondi: B.Curri, fl. 4-10 (pa datë).